



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI

PËR	z. Hekuran Murati, Ministër i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve
NJOFTIM:	z. Ferit Idrizi - Kryetar i Komunës
NGA:	Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë 
PËRMES:	Sekretarisë së Kuvendit
TEMA:	Kërkesë për pezullimin e vendimit për vlerësimin e përgjithshëm të pronave rezidenciale

I nderuar ministër,

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më datë: **31 janar 2023**, pasi ka shqyrtuar ankesat e shumta të qytetarëve për obligimet pas rritjes së normave tatimore, dhe duke marrë për bazë gjendjen e rëndë ekonomike dhe sociale që po mbretëron në vendin tonë si rezultat i inflacionit të lartë, pas një analize të hollësishme parashtron këtë:

Kërkesë

Siç është e ditur kuvendet komunale nuk kanë të drejtë të falin tatimin në pronë, sepse janë obligime që rrjedhin nga Ligji Nr.06/L-005 i Tatimit në Pronë, i aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Andaj Kuvendi i komunës kërkon:

1. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me vendim të pezullojë aplikimin e rivlerësimit të patundshmërive në vend;
2. Faturat e tatimit në pronë të llogariten të njëjta si në vitin e kaluar (2022);
3. Së pari të amendamentohet Ligji Nr.06/L-005 i Tatimit në Pronë, neni 9 (normat tatimore);
4. Kërkojmë që për shkak të gjendjes së rëndë sociale të falen obligimet deri në 100 euro për çdo tatimpagues.

Me respekt!